



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA
INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



▼ DORACA PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Doracak për Bashkëpunim Ndër-Komunal

I. Doracak për BNK:

*“Ardhja së bashku është fillimi.
Qëndrimi së bashku është progres.
Puna së bashku është sukses.”
- Henry Ford*

I. Hyrje

Bashkëpunimi ndër-komunal (BNK) është një rrugë e rëndësishme për komunat në lidhje me ofrimin efikas dhe efektiv të shërbimeve. Komunat gjithandej performojnë funksione qenësore të cilat përcaktojnë cilësinë e jetesës së qytetarëve si dhe mirëqenien kolektive, sikurse janë: rrugët dhe trafiku, transporti, furnizimi me ujë, shkollat dhe foshnjoret, qendrat e shëndetit, hapësirat sportive, mbledhja e mbeturinave, muzetë, teatrot dhe qendrat muzikore, madje edhe varrezat.

2. Grupi/et e Targetuara

Udhëzuesi për BNK është një burim i çmuar për:

- zyrtarët e zgjedhur,
- pjesëtarët aktiv në komunitet,
- përfaqësuesit e komunitetit,
- zyrtarët e qeverisë,
- konsulentët,
- planifikuesit dhe profesionistë të tjerë të cilët përpjekën që të zbatojnë dhe mirëmbajnë praktika të qëndrueshme

Grupet kryesore për këtë doracak janë: Asociacionet Ndër-Komunale, Kryetaret, Përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale, dhe ekspertet e fushave

Kryetaret dhe zyrtarët kryesor të komunave duhet të jenë në gjendje që të gjejnë rrugët për të tejkaluar sfidat si dhe të shfrytëzojnë mekanizmat ligjor për të forcuar bashkëpunimin ndër-komunal si dhe proceset ndër-kufitare me përfitim për të gjitha palët.

3. Synimet

Synimi i këtij doracaku është t'i ofroj komunave informacion; burime dhe mjete të cilat nevojiten për të filluar dhe vazhduar marrëdhënie të punës efektive me komunat tjera. Doracaku sjellë informacion adekuat në lidhje me:

- fillimin e procesit bashkëpunues;
- aranzhimin e strukturave të punës të BNK; dhe,
- menaxhimin e BNK

II. Korniza e BNK

4. Përshkrimi i BNK

Përshkrimi i definicionit të BNK, karakteristikave dhe rëndësisë së këtij koncepti i ndihmon grupit/eve të targetuara që të kenë një vështrim më të qartë në lidhje me këtë subjekt, si dhe një orientim më të mirë kundrejt BNK.

- Definimi i BNK
- Karakteristikat e BNK
- Rëndësia e BNK

“Bashkëpunimi është një akt apo instancë e punës apo veprimit së bashku për të mirën apo përfitimin publik.”

5. Bazat e BNK

BNK është një rrugë efektive për t'u marr me çështjet me interes reciprok të cilat shkojnë përtej përkufizimeve ligjore. Fjala është prioritetet lokale, ato të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin, zhvillimi ekonomik, sikurse shërbimet, si dhe ofrimi i shërbimeve mund që lehtësisht të zgjidhen nëpërmes veprimeve regjionale. BNK krijon mundësi të cilat komunat individualisht nuk mund t'i arrijnë. Gjithashtu është me rëndësi të përmendet që BNK nuk është një proces i integritit të komunave, por është proces i punës së bashku për të krijuar hapësirë më të madhe të mundësive. Në këtë linjë, mes tjerash, bazat e BNK janë:

- ✓ BNK bazohet në interesin e përbashkët;
- ✓ BNK ka të bëjë me një apo disa funksione ligjore dhe të politikave në komuna;
- ✓ BNK bazohet në vullnetin e lirë më shumë se sa nga ligji, edhe pse ky i fundit mund të kërkojë nga qeveritë lokale që të gjejnë zgjidhje bashkëpunimi;
- ✓ BNK nënkupton ndarjen e roleve dhe përgjegjësi;
- ✓ BNK përfshin ndarjen e rreziqeve, kontrollit dhe përfitimeve;
- ✓ BNK nuk është ad hoc – ka një kohëzgjatje të caktuar dhe në të shumtën e rasteve është një aranzhim i përhershëm;

- ✓ BNK mund të ketë një datë të pacaktuar të përfundimit;
- ✓ BNK është fleksibil dhe dinamik – i përgjigjet ndryshimeve në rrethana dhe formë
- ✓ BNK evoluon përgjatë kohës;
- ✓ BNK nuk përfshinë bartjen e plotë të funksioneve komunale – qeverive lokale
- ✓ BNK së paku mban një kontroll jo të drejtpërdrejt në lidhje me vendimet të cilat rezultojnë nga bashkëpunimi

6. Struktura e BNK

Varësisht nga legjislacioni i caktuar në lidhje me qeverisjen lokale, vende të ndryshme kanë struktura të ndryshme të cilat mund të shfrytëzohen për themelimin e BNK-s. Gjithashtu, një legjislacion i tillë përshkruan ose lejon themelimin e strukturave të caktuara në lidhje me BNK. Mes tjerash, këto janë disa struktura të zakonshme të BNK në rajon:

- ✓ Zyrtaret e Komunave
- ✓ Trupat dhe Komisionet e Përbashkëta
- ✓ Institucionet e Përbashkëta Publike
- ✓ Ndërmarrjet e Përbashkëta Publike
- ✓ Trupat Komunal
- ✓ Kompanitë Publike Komunale/Ndërmarrjet

7. Fushat e BNK

Është me rëndësi të theksohet që në të shumtën e rasteve karakteristikat e qeverisë lokale nuk dallojnë njëra nga tjetra. Në këtë aspekt, duke themeluar BNK komunat shtrijnë dhe zgjerojnë nivelin e intervenimit të tyre.

- ✓ **Funksionet Komunale**
 - ✓ Menaxhimi me burime njerëzore
 - ✓ Baza elektronike e të dhënave
 - ✓ Prokurimi i pajisjeve
- ✓ **Zhvillimi Socio-Ekonomik**
 - ✓ Planifikimi zhvillimor
 - ✓ Planifikimi urban
 - ✓ Zhvillimi i biznesit (qendrat përkrahëse të biznesit)
 - ✓ Mbrojtja e ambientit
- ✓ **Infrastruktura dhe Shërbimet Publike**
 - ✓ Mbledhja e mbeturinave

- ✓ Furnizimi me ujë dhe kanalizimi
- ✓ Transporti publik
- ✓ **Shëndeti, edukimi dhe kultura**
 - ✓ Spitalet
 - ✓ Kopshtet dhe shkollat
 - ✓ Infrastruktura dhe aktivitetet sportive
- ✓ **Infrastruktura**
 - ✓ Ndërtimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre
- ✓ **Rendi publik dhe mbrojtja civile**
 - ✓ Njësitë e zjarrfikësve dhe shërbimet e shpëtimit

Në Kosovë ekzistojnë dëshmi e sukseseve në BNK në proceset e projekteve të përbashkëta në infrastrukturën e ndërtimit të rrugëve dhe mirëmbajtjes në shumë komuna. Për më shumë, BNK strukturat adresojnë çështje në lidhje me disa probleme të vogla ndërsa ato më të mëdha mund të përfshijnë dy apo më shumë komuna. Edhe pse ka raste të bashkëpunimit, është me rëndësi që komunat të bashkëpunojnë në fusha të ndryshme dhe jo vetëm në infrastrukture. Shumë raste shfaqin nevojën për BNK në çështje të zhvillimit socio-ekonomik dhe në ndërtim të ofrimit të shërbimeve.

Praktika evropiane e BNK është shumë e përhapur në pesë fushat vijuese:

Ofrimi/prodhimi i Përbashkët i Shërbimeve: Përfshin bashkëpunimin në ofrimin e shërbimeve publike sikurse janë: furnizimi me ujë, mbledhja e mbeturinave dhe transporti publik. Në përgjithësi konsiston në bashkëpunimin afat gjatë në formë të ndërmarrjeve të përbashkëta apo në formë të asociacioneve ndër-komunale sipas ligjit publik.

Administrata e Përbashkët: Mund të përfshijë fusha të ndryshme sikurse mbledhja e taksave dhe administrata, planifikimi urban, lëshimi i lejeve të ndërtimit apo rregullimi i transportit publik. Kjo shpesh përfshinë themelimin e zyrave të përbashkëta të cilat performojnë funksionet e disa komunave.

Shitja dhe Blerja e shërbimeve ndërmjet qeverive lokale: Tipikisht përfshinë komunat administrativisht dhe financiarisht të forta të cilat mund t'i ofrojnë shërbime komunave më pak të forta si kompensim në formë pagesash. Mund të përfshijë fushën e administratës apo edhe ofrimin e shërbimeve.

Planifikimi i përbashkët dhe zhvillimi: Planifikimi i përbashkët dhe zhvillimi shfrytëzohen në fushat kur një komunë është shumë e vogël territorialisht dhe/apo në territor në mënyrë që efektivisht promovoj zhvillimin ekonomik si dhe të zhvilloj turizmin potencial.

Planifikimi i përbashkët dhe zhvillimi gjithashtu shfrytëzohet në kontekst të BNK-ve të themeluara në hapësira metroplitare.

Financimi i përbashkët: *Financimi i përbashkët është praktikë kur disa komuna fqinje mes vete i bashkojnë burimet e tyre në mënyrë që të ndërmarrin investime me përfitim për të gjithë (p.sh ndërtimi i një aeroporti apo ure). Gjithashtu kjo formë shfrytëzohet nga komunat në mënyrë që të arrihet qasja në projekte të financuara të cilat kërkojnë bashkëfinancim komunal, duke mos qenë në pozitë që t'i qasen këtyre projekteve individualisht.*

8. Përfitimi nga BNK

BNK është një mënyrë e shkëlqyer për sukses komunal; në shkallë të madhe ngritë cilësinë ekonomike, politike, sociale dhe ambientale të jetesës. Përfitimet që rrjedhin nga BNK mund të kategorizohen ndërmjet:

- ✓ **Shkëmbimit të informative dhe përvojave.** Të gjitha komunitetet përballen me nivele të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit, prandaj edhe mund të përfitojnë nga informatat dhe përvojat e njëra tjetrës.
- ✓ **Fuqizojnë ofrimin e shërbimeve.** Në parim çmimi-për-njësi në ofrimin e shërbimeve bie atëherë kur një grup më i madh i njerëzve shfrytëzon shërbimin. BNK mund të ndihmoj në uljen e këtyre çmimeve duke arritur një nivel ekonomik dhe duke lejuar që furnizimin më efikas dhe më të fuqizuar, përfshirë ato profesionale duke i shfrytëzuar burimet më efektivisht. P.sh . Zyrtar i përbashkët për zhvillim ekonomik, Inspektor i përbashkët i ndërtimit, Planifikues i përbashkët, këmbimi i mjeteve, etj.
- ✓ **Përqendrimi në ndërtimin e një rajoni të fortë.** Sfidat ekonomike dhe sociale janë duke u bërë përherë e më shumë rajonale. Komunat të vetme, në vend se të provojnë vetëm hapjen e vendeve të punës dhe tërheqjen e njerëzve në nivel lokal, duke u angazhuar në BNK mund të përqendrohen në qasje rajonale e cila siguron investime, rritje dhe prosperitet duke ofruar mundësi, shërbime dhe pasuri. Nëpërmes BNK, iniciativat e përbashkëta, shërbimet dhe infrastruktura, komunat mund të reduktojnë shpenzimet, mund të ofrojnë mundësi më të mëdha të aprovimit të granateve si dhe më shumë siguri të cilën nuk mund ta kenë në iniciativa individuale. P.sh . Hapësirat turistike, shëndeti, shkollat, shërbimet rekreacionale, biznesi. Etj.
- ✓ **Planifikimi dhe zhvillimi.** Popullata, demografia dhe ekonomia janë duke ndryshuar vazhdimisht, dhe kjo shkakton një sfida të shumta për komunat në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukture së re. BNK mund t'ju ndihmoj komunave t'i zhvillojnë këto shërbime si dhe ta financojnë infrastrukturën të cilën nuk do të mund ta bënin individualisht.

- ✓ **Planifikimi Konsistent.** Politikat e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës dhe zonat e ndara me ligj mund të reduktojnë komplikimet dhe rreziqet për ata të cilët kërkojnë të investojnë në rajon. Politikat e përbashkëta për sektor të biznesit (naftë dhe gas, agrobiznes, apo zhvillimi i vendbanimeve) paraqesin rajon më atraktiv atëherë kur kompanitë e dinë që mund të investojnë dhe të kenë standarde uniforme.
- ✓ **Përmirësimi i cilësisë së jetesës.** BNK tërheq zgjidhje dhe burime për të zgjidhur çështje dhe probleme lokale, si për të përmbushur kolektivisht nevojat e qytetarëve në rajon – duke ju mundësuar qytetarëve që më mirë të kuptojnë problemet që ata dhe fqinjët e tyre hasin, në mënyrë që të gjenden zgjidhje kolektive. Lejon përhapjen e ideve inovative dhe zgjeron zgjedhjet e shërbimeve.
- ✓ **Fuqizon.** Ndarjen e rreziqeve, kontrollit dhe përfitimeve. BNK mund të ul rrezikun me të cilin mund të përballet komuna e vetme. Shpenzimet e reduktuara në shërbime të përbashkëta mund të lejoj financimin e aspekteve tjera në kuadër të qeverisjes komunale. Përgjegjësia shpërndahet në mënyrë të balancuar, duke mundësuar kështu qeverisje më të mirë në nivelin individual të komunave. Në përgjithësi, krijon më komune me efikase me efektive dhe më inovative.
- ✓ **Siguron konsistence.** BNK siguron që ri prodhimi i pa nevojshëm i shërbimeve nuk do të ndodh. Gjithashtu shpërndanë koston e shërbimeve regjionale.
- ✓ **Efektet anësore.** BNK gjithashtu potencialisht ka dhjetëra aspekte anësore të përfitimit, sikurse konsultimi, kompromisi, vlerësimi. Përgjithësisht, BNK gjeneron një kulture të bashkëpunimit organizativ dhe të ndërtimit të besimit; optimizion shfrytëzimin e njohurive dhe përvojës nga komunat partnere; inkurajon përqendrimin në problem reale përtej ndarjeve politike – bashkëpunimi mes komunave të udhëhequra nga disa parti politike mund të ndikoj në praktiken e menaxhimit të partnerëve të cilët mund të cilët mund t'i përsërisin procedurat më të sofistikuar të BNK-s; mund të krijojnë hapësire për ndër-veprim më të madh me shoqëri civile sikurse OJQ-të, asociatat e biznesit dhe asociacioneve civile.
- ✓ Reduktimi i çmimit-për-njësi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike nëpërmes përparimit të ekonomisë dhe qasjes në teknologji më të përparuar.
- ✓ Arritje e një madhësie minimale e cila arsyeton ofrimin e shërbimit.

- ✓ Tërheq fonde investimi nga publiku, burime private dhe donacione në lidhje me projektet që kanë të specifikuar madhësinë minimale.

III. Inicimi i BNK

BNK duhet të bazohet në adresimin e nevojave të komunës dhe qytetarëve të saj.

9. Analizë e Rrethanave

- ✓ **Identifikoj nevojat dhe mundësitë**

- BNK duhet të jetë adekuate dhe e përshtatshme në mënyrën se si zgjidh problemet dhe se si arrin qëllimet.

- ✓ **Identifikimi i partnerëve dhe fushave potenciale të bashkëpunimit**

- Të cilët janë parter potencial (komuna) të motivuar për bashkëpunim
- A janë parakushtet e nevojshme për iniciimin e një BNK-je?
- Cilat janë fushat kryesore me interes për komunat të cilat dëshirojnë të iniciojnë një BNK.

- ✓ **Ndërmerr një studim fizibiliteti:**

- Analizë të situatës
- Siguron përshkrimin e sfidave dhe mundësive reale
- Në terma real financiar dhe praktik arsyeton nevojën për BNK
- Përshkruan përparësitë dhe dobësitë e komunave kanë lidhje me BNK e paraparë
- Justifikon qëndrueshmërinë e BNK
- Siguron platformë për iniciimin e BNK
- Shpjegon efektet potenciale anësore të BNK
- Parashih BNK ndikimin në terren.

10. Materializimi i BNK

- ✓ **Konsultimet fillestare**

- Struktura dhe agjenda konsultative
- Identifikoj akteret përgjegjës

Zhvillimi i Marrëveshjeve të BNK

BNK janë marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet dy apo më shumë komunave. Zakonisht, këto marrëveshje vendosin aranzhmane specifike të cilat theksojnë se si komunat e përfshira mund të ndajnë shërbime të përbashkëta.

Një marrëveshje është e rëndësishme të ekzistojë për një numër arsyesh:

1. Qartë thekson përgjegjësitë dhe aranzhmanet ndërmjet palëve dhe të interesuarve;
2. Ato eliminojnë keqkuptimet dhe sigurojnë korrektësi ndërmjet palëve;
3. Ato sigurojnë bazat për aranzhmanet në ndryshim; dhe,
4. Sigurojnë mënyra për planifikim të vazhdueshëm.

Më specifikisht, BNK marrëveshja përmban:

- Synimi i marrëveshjes
- Kohëzgjatja e marrëveshjes
- Fusha dhe shtrirja e marrëveshjes
- Të drejtat dhe obligimet e secilës palë
- Rregulloret me të cilat udhëhiqet Bordi Menaxhues (nëse ka ndonjë të tillë)
- Rregulloret me të cilat udhëhiqet Trupi Mbikëqyrës (nëse ka ndonjë të tillë)
- Përzgjedhjen e Drejtorit (nëse ka ndonjë të tillë)
- Organizimi/menaxhimi i aktiviteteve
- Buxheti, përlogaritë dhe auditimi
- Kontributi i secilës komunë (financat dhe pasuria)
- Të drejtat në lidhje me pronësinë, shfrytëzimi, shpërndarja dhe vizibiliteti (për shërbimet e dala nga BNK)
- Përgjegjësitë e palëve
- Amendamentet e marrëveshjes
- Pranimi dhe dalja e partnereve
- Shpërbërja e BNK
- Zgjidhja e konflikteve
- Mbikëqyrja/kontrulli
- Mekanizmat vlerësues dhe monitorues
- Plani i punës dhe orari i aktiviteteve

- Përfshirja në komunikim (kërkon inputin e tyre) me akteret përgjegjës në lidhje me agjendën
- Pajtohet në lidhje me orarin e takimeve
- Përzgjedhin fushat e përbashkëta të bashkëpunimit
- Angazhohet në lidhje me hapat e ardhshëm

✓ **Themelon strukturat e bashkëpunimit**

- Pajtohet platforma e BNK
- Themelon:
Menxhmentin/Koordinimin/Administrimin/Institucionin Përgjegjës të BNK-së
- Definohet mandate i institucionit respektiv të BNK

✓ **Definimi i aranzhmaneve formale të bashkëpunimit**

- Vendoset një propozim i hollësishëm përfundimtar përfshirë edhe implikimet

- Aprovimi formal i BNK nga ana e komunave respektive.

IV. Menaxhimi me informata dhe njohuri

Menaxhimi i informatave dhe njohurive është komponentë kritike për çfarëdo politike e cila promovon BNK-në. Kjo është një karakteristike e zakonshme në Evropën Lindore. Informacioni në përkrahje të inicimit të BNK përfshin:

- Manualet dhe udhëzimet në lidhje me BNK
- Kontratat dhe statutet
- Paketa e legjislacioni relevant
- Baza e të dhënave në lidhje me trajnerët/ekspertët (privat, qeveria qendrore apo lokale)
- Regjistrimi i iniciativave të BNK-ve
- Mbledhja dhe shpërndarja e praktikave të mira (vendor dhe ndërkombëtar)
- Rastet studimore dhe identifikimi i përvojave
- Kanalet e shpërndarjes së informatave në lidhje me BNK gjithashtu ka të bëjë me;
- Ëeb faqet
- Seminaret dhe punëtoritë
- Rrjetet e BNK-s
- Gazetat

Informata, manualet dhe format

- Doracaku i BNK-së
- Doracaku për Studimin e Fizibilitetit
- Forumet dhe pyetjet e shpeshta
- Format dhe kërkesat për alokime të fondeve
- Drafti i statuteve,
- Aktet kushtetuese

Përkrahja e Jashtme

- Vendimi për partneritet dhe përkrahja në zbatimin e BNK-së
- Përkrahja e studimeve të fizibilitetit
- Përkrahja e ri-organizimit

Seminaret dhe Publikimet

- Publikimet
- Raportet
- Seminaret
- Takimet

Përhapja

- Faqet e internetit
- Identifikimi i përvojave
- Regjistrimi i përvojave
- Baza e të dhënave rajonale
- Përhapja e praktikave të mira

V. Rekomandimet për Sukses

Bazat solide në fazat fillestare lejojnë një potencial më të madh për sukses përgjatë gjithë procesit.

Përdorimi i përbashkët i mjeteve. Disa komuna nuk shfrytëzojnë sa duhet pajisjet e tyre ndërsa disa të tjera thjeshtë nuk mund të blejnë pajisje. Në vijim do t'ju ofrojmë disa mënyra se si mund të bashkëpunojnë komunat në këtë drejtim:

- **Marrëveshjet për qiradhënie.** Komunat të cilat posedojnë pajisje mund t'i ofrojnë me qira ato pajisje për komunat të cilat nuk mund t'i blejnë ato. Komunat duhet të hyjnë në marrëveshje qiradhënie/marrje të cilat ofrojnë hollësira në lidhje me aranzhmanet dhe çmimet.
- **Pronësia e Përbashkët.** Dy (apo më shumë) komuna posedojnë pajisjet. Kjo formë e bashkëpunimit përfshinë hollësira më të shumta p.sh. oraret në lidhje me pajisjet, aranzhmanet në lidhje me shpenzimet/çmimet, ku do të vendoset, mirëmbajtja, etj.
- **Tregtimi i Pajisjeve.** Komunat mund të shkëmbejnë një pajisje për një tjetër për një periudhë të caktuar kohore. Hyrja në marrëveshje tregtimi do të ishte formë e lehtë e shkëmbimit të pajisjeve.
- **Kujdesi**
Është lehtë të humbet formaliteti dhe struktura në momentin kur arrihet qëllimi. Është me rëndësi të vazhdohet me takime të rregullta dhe procedura të strukturuar në mënyrë që formaliteti të mos humbet. Ruaj momentumin.
- **Qëndro në Rrjedha**
Bëhu i kujdesshëm në lidhje me çështjet që shtrohen. Qëndro mendje hapur dhe i vullnetshëm në mënyrë që të provohet diçka e re; rreziku mund të shpie deri të suksesi.
- **Qëndro Pozitiv**
Ruaj qëndrimin pozitiv. Duke mësuar nga gabimet është formë e mirë për t'u marr me to.
- **Bëhu i Durueshëm**
Disa nisma mund të marrin më shumë kohë mirëpo me procedura të rregullta, qëllimet mund të arrihen! Mbani mend, hapat e vegjël mund të marrin kohë por mund të jenë më efikas dhe mund të ju dërgojnë atje ku dëshironi!
- **Mendo Rajonalisht**
Është me rëndësi të mbahet një këndvështrim rajonal në lidhje me gjërat, por jo në dëm të nevojave më të veçanta. Qëllimet e grupit të punës shërbejnë për përfitime tuaja dhe të partnerëve.

- **Komunikoni**
Megjithëse tingëllon thjeshtë, është me rëndësi të komunikohet me komunat partnere. Mbaj ato të informuara në lidhje me ndryshimet apo në lidhje me çështjet që dalin në pah. Komunikimi duhet të përdoret përtej takimeve të rregullta.

VI. Mekanizmat e Zgjidhjes së Keqkuptimeve/Konflikteve

Konflikti është një mosmarrëveshje të cilën palët e përfshira e perceptojnë si kërcënim ndaj nevojave, interesave apo brengave të tyre. Grupet e punës pa mekanizma të zgjidhjes së konflikteve synojnë që t'i zgjidhin ato në momentin kur nevojat e tyre fillestare përmbushen, kur vendimet e rëndësishme pritet të merren, apo kur thjeshtë palët nuk mund të pajtohen. Duke pasur mekanizmat e zgjidhjes së konflikteve, komunat mund të qëndrojnë së bashku si grup edhe kur çështjet e ndryshme dalin në pah. Ka një mori mjetesh të zgjidhjes së konflikteve që duhet të konsiderohen kur është fjala për bashkëpunim në baza rajonale.

✓ **Vendos themelet në fillim të çdo Iniciative Ndër-Komunale**

- **Identifikoj Rolet.** Identifikoj rolet e grupit në fillim të procesit në mënyrë që të gjithë të interesuarit (komunat) të jenë në dijeni për synimet dhe në lidhje me at pritet duke qenë pjese e grupit ndër-komunal të punës.
- **Zgjedh një Facilitues.** Vendosni se a do të keni një facilitues të jashtëm, facilitues rotativ, apo një kryesues/bashkë kryesues të rregullt, është me rëndësi të sigurohet që të gjithë të interesuarit të kenë mundësi të barabarta që të marrin pjesë në takimet e organizuara në mënyrë që të mënjanohet konfuzioni dhe të ruhet momentum.
- **Ruaje Barazinë.** Kujto që pavarësisht madhësisë apo bazës së taksave, të gjitha komunat të cilat marrin pjesë në BNK janë të barabarta dhe duhet të kenë mundësinë që të luajnë rol të barabartë në kuadër të grupit.

Rregullat Themelore

Themelo rregullat themelore për takimet tuaja në grup. Si grup përcakto paraprakisht se cilat aksione nuk do të tolerohen në rast se kërkohet që të punohet me efikasitet si grup. Këto rregulla elementare mund të rifreskohen në rast se paraqiten çështje të reja. Si shembull të disa rregullave themelore mund të kemi:

- **Respekti.** Keqpërdorimi verbal apo fizik nuk lejohet. Asnjë sjellje ngacmuese, mbi bazën e moshës, raciste apo mbi bazë të dallimeve gjuhësorë nuk lejohet.
- **Hapësira.** Njerëzit meritojnë kohë dhe hapësirë për të thënë atë që mendojnë, kjo nënkupton që nuk duhet të pengohen.
- **Kujdesi.** Bëje me të mirën për të qenë i ndjeshëm dhe për të përmbushur nevojat e të tjerëve në grup.

- **Konfidencialiteti.** Informata personale e ndarë brenda grupit mbetet brenda grupit.

...të Parandalohet Konflikti Kur Komunikoni me të Tjerë Anëtarë të Grupit

- *Njihe Vetën! Menaxho emocionet tuaja dhe dije se si të mbash vetën.*
- *Komuniko: Dëgjimi Efektiv & Të Shprehurit Efektiv.*
- *Ofro dhe Prano Përshtypjet/Reagimin: Mos kritiko; sigurohu që komentet tuaja do të ndihmojnë në përmirësimin e situatës.*
- *Bashkëpunohet dhe Negocio me Korrektësi.*
- *Identifiko Konfliktet & Zhvillo Opsionet: Si grup, vendos në lidhje me metodën për të gjetur zgjidhjet për çështjet aktuale.*
- *Shfrytëzo qasjen fito-fito: Zgjidh çështjet si partner dhe jo si kundërshtar.*
- *Zgjidhja Kreative e Problemeve: Kthej problemet në mundësi. Më shumë se sa të kërkohet ana negative e çështjes, shiko cilat mundësi mund të shfaqen duke e adresuar çështjen si rajon.*

Mekanizmat e Zgjidhjes së Konfliktëve

Nëse një grup i punës futet në një marrëveshje (p.sh. Memorandum Mirëkuptimi apo Aprovon Ndonjë Plan Rajonal, etj) është me rëndësi që vendosen metoda/t e zgjidhjes së konfliktëve. Është praktikë e mirë që kjo informatë të përfshihet brenda çdo marrëveshje të shkruar. Kjo politikë përfshinë”

- Definimin e konfliktit: p.sh. mosmarrëveshjet për politika publike në lidhje me vendimet apo politikat e komunave; mosmarrëveshjet në lidhje me politikat e implementimit; konfliktet organizative; mosmarrëveshjet kontraktuale, etj.
- Inicimi i procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjet.
- Mekanizmat e zgjidhjes (ndërmjetësimi, ligji, arbitrimi) – p.sh. Komision për rishikim, komisioni i rishikimit të administrimit dhe procesit, ndërmjetësimi, etj.
- *Kufizimi kohor – p.sh. cila është periudha e arsyeshme për zgjidhjen e konfliktit.*

Modelet Formale të Zgjidhjes së Konfliktëve

- **Negocimi.** Negocimi është metode për zgjidhjen e konfliktëve kur ato paraqiten. Rezultati duhet të kënaq interesat e palëve të përfshira, mirëpo pjesëmarrja në negociata është vullnetare dhe nuk ka ndonjë palë të tretë e cila lehtëson apo imponon një proces të zgjidhjes së konfliktit.
- **Ndërmjetësimi.** Në ndërmjetësim, pala e tretë e cila faciliton zgjidhjen mund të sugjeroj ndonjë zgjidhje.

- **Arbitrimi.** Pjesëmarrja nuk është tipikisht vullnetare. Thënë thjesht, procesi shfrytëzon një palë të tretë e cila imponon zgjidhje. Arbitrimi jo obligativ shfrytëzohet për të parë se ku do të arrijnë palët e përfshira, në rast se pala neutrale pritet të vendos një zgjidhje, mirëpo kryesisht arbitrimi shfrytëzohet për të arritur zgjidhje të detyrueshme në mënyrë që t'i jepet fund mosmarrëveshjet.

VII> Përfundimet

BNK është një nga mënyrat dhe rrugët me efektive për komuna që të arrijnë sukses. BNK ju ofron komunave mjete për të punuar së bashku lokalisht dhe të:

- **Këmbejnë njohuritë**
- **Përforcojnë ofrimin e shërbimeve**
- **Të përqendrohen në ndërtimin e një rajoni të fort**
- **Që efektivisht të planifikojnë zhvillimin**
- **Të praktikojnë planifikimin konsistent**
- **Të përmirësojnë cilësinë e jetesës**
- **Të ndajnë rreziqet dhe kontrollin.**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).